

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ROCK OF KAVAJA” SH.P.K.**

Sot, më datë 12.07.2024, unë i nënshkruari:

**“ELDEMAR CONSTRUCTION” shpk.**, shoqëri tregtare e së drejtës Shqiptare, e regjistruar në regjistrin tregtar të QKB me datë 14.05.2010, me seli në adresën Durrës Sukth KULLE Fshati Kulle, Zona Kadastrale 2321, Godinë me nr. pasurie 204/7, e pajsur me NUIS nr. L01714506V; përfaqësuar nga Administratori i vetëm **z. Gëzim HASA**, atësia Tomorr, shtetas shqiptar, lindur më 08.10.1984, në Durrës dhe banues në Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 036200701 dhe Nr. Personal: I41008115M leshuar me date 13.07.2020,

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar ; Ligjin nr. 9723. datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar ; dhe Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“Rock of Kavaja” sh.p.k.**

(më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

**Neni 1 – Emërtimi**

Emri i Shoqërisë është **“Rock of Kavaja” sh.p.k.**

**Neni 2 - Selia**

**Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Durrës, Rruga Durrësi në shekuj , Lagja nr14. Shkozet.**

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë, filiale, apo zyra përfaqësimi, gjate aktivitetit të saj, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 4 - Objekti i Veprimtarisë**

**Objekti i Veprimtarisë është:**

Investime të ndryshme në fushën e hoteleri-turizmit dhe strukturave rezidenciale. Zhvillim, ndërtim, administrim dhe operim i strukturave turistike/hoteliere dhe rezidenciale duke përfshirë këtu hotele, apart-hotele, vila, apartamente banimi, ambiente shërbimi, qendra tregtare, ambiente rekreative dhe argetuese, etj. Shitje dhe dhënie me qira e pasurive të paluajtshme.

## Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë

- 1.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 1.2. Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 100 (njëqind) kuota, me vlerën prej 1.000 (një mijë) lekë secila.
- 1.3. Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë: **Eldemar Construction shpk**, zotërues i 100 (njëqind) kuotave me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **Neni 6 – Shpërndarja dhe Transferimi i Kuotave**

- 6.1. Shpërndarja e kuotave të kapitalit të shoqërisë është bërë si mëposhtë :  
100 (njëqind) kuota, që korrespondon me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë zotërohet nga:
  - **“ELDEMAR CONSTRUCTION” shpk.**, shoqëri tregtare e së drejtës Shqiptare, e regjistruar në regjistrin tregtar të QKB me datë 14.05.2010, me seli në adresën Durrës Sukth KULLE Fshati Kulle, Zona Kadastrale 2321, Godinë me nr. pasurie 204/7, e pajsur me NUIS nr. L01714506V; përfaqësuar nga Administratori i vetëm **z. Gëzim HASA**, atësia Tomorr, shtetas shqiptar, lindur më 08.10.1984, në Durrës dhe banues në Durrës, i identifikuar me letërnjoftimin me nr personal 036200701 leshuar me date 13.07.2020.;
  - Ortaku i Vetëm i shoqërisë ka depozituar kapitalin fillestar të shoqërisë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë në llogarinë bankare.
- 6.2. Ortaku i Vetëm mund të vendosë të rrisë kapitalin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- 6.3. Detyrimet e Ortakut të Vetëm kundrejt Shoqërisë janë të kufizuara dhe do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij. Ortaku i Vetëm nuk do të ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera eventuale të Shoqërisë.
- 6.4. Kuotat e shoqërisë mund tu transferohen të tretëve, në përputhje me procedurat dhe modalitetet e përcaktuara në Statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

## Neni 7 – Organet e Shoqërisë

- 7.1. Shoqëria është e organizuar si mëposhtë:
  - Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë,
  - Administratori.
- 7.2. Administrator i Vetëm i Shoqërisë është:  
**Z. Rezart Dedej**, shtetas shqiptar, lindur lindur në Durrës, me 03.04.1984, me banim në Shkallnur, Durrës, Shqipëri, zotërues i Pasaportës / ID me nr. 038216681 dhe me nr. Personal I40403201E, e lëshuar nga autoritetet Shqiptare, datë 19.04.2022, i cili zgjidhet për një afat 5 vjeçar , nga data 12.07.2024-11.07.2029.

Kohëzgjatja e emërimit të tij përcaktohet nga Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

- 7.3. Kompetencat dhe fuqitë e Ortakut të Vetëm Shoqërisë dhe të Administratorit të Shoqërisë janë të parashikuara dhe përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Marrëdhëniet e Punës**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit sektorial të punës në fuqi, në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit, si dhe të punësuarit janë të detyruar gjithashtu, që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjislacionit në fuqi.

#### **Neni 9 - Konfidencialiteti**

Të gjitha aktet dhe dokumentat që përcaktohen si konfidenciale nga Administratori/ët e Shoqërisë, do të duhet të konsiderohen dhe trajtohen si të tilla edhe nga punonjësit e tjerë të Shoqërisë, dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët.

#### **Neni 12 - Gjuha**

Akti i Themelimit është hartuar dhe firmosur në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përsa i përket interpretimit të këtij Akti Themelimi, versioni në gjuhën shqipe do të jetë i vetmi ligjërishit i vlefshëm.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË  
“Eldemar Construction” SH.P.K.**

**PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI**

**z. Gëzim HASA**

